



Deri: Entet radiodifuzive jo fitimprurëse

Për: Drejtorin

Lënda: Informacion për obligimet të cilat dalin nga Ligji për media dhe nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele

Të nderuar,

Nga data 3 janar të vitit 2014 në fuqi hyjnë Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele dhe Ligji për media („Gazeta zyrtare e RM-ës “ nr. 184/2013).

U njoftojmë se Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele, si pasues ligjor i Këshillit të radiodifuzionit, sipas detyrimit zyrtar do të realizojë ndërrimin e lejeve të deritanishme për ushtrim të veprimtarisë radiodifuzive me leje të reja për radio emetim në afat prej 30 ditëve nga dita e sjelljes së vendimit për zgjedhje të Drejtorit të Agjencisë. Leja e re do të vlejë nëntë vite që nga dita e marrjes së sajë.

Tekstet e të dy Ligjeve do të publikohen në ueb faqen e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (www.avmu.mk), Më poshtë në shkrim ju informojmë për detyrimet të cilat serviset Radio programore do ti kenë në pajtueshmëri me këto dy Ligje. Disa nga këto detyrime janë të njëjta si ato të deritanishmet, disa janë të modifikuara (të ndryshuara), ndërsa disa janë të reja:

- Emërimi i redaktorit përgjegjës (neni 8 nga Ligji për media);
- Publikimi i informacioneve për emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së emetuesit të medias, bartësit e të drejtave të autorit, datën dhe origjinën e produksionit në vend të duhur për çdo përmbajtje të transmetuar (neni 14 nga Ligji për media);
- Sigurimi i publikut në punën nëpërmjet publikimit të të dhënave për strukturën pronësore, redaktorët përgjegjës, burimet e financimit, të ardhurat dhe shpenzimet mesatarisht nga dëgjimi (neni 15 nga Ligji për media);
- Dorëzimi i raportit në formë të shkruar deri tek trupi rregullator në të cilën do të tregohet zbatimi i obligimeve të përcaktuara në lejen për emetimin e programit, veçanërisht në koncept programor, një herë në vit, më vonë deri më 31 mars në këtë vit (Neni 15 nga Ligji për media);
- Publikimi i korrigjimeve respektivisht përgjigje e informatës së publikuar (nenet 18, 19, 20, 21, 23 dhe 27 nga Ligji për media);
- Mundësim pa ndërprerë mbikëqyrje nga ana e personave të autorizuar nga Agjencia për

Shkup _____ viti
2014.



**Agjencia për
shërbime mediatike
audio dhe
audiovizuele**

**Bul. VMRO nr.3
1000Shkup
Republika e
Maqedonisë**

Tel.(02) 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact @avmu.mk**



shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (Neni 33 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);

- Respektimi i rregullave për mbrojtjen e pluralizmit dhe të shumëllojshmërisë të strukturës së shërbimeve mediatike (Neni 34 dhe 43 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Evidencë ditore të programit të emetuar dhe ta incizojnë sinjalin dalës të programit të vet, (Neni 47 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Sigurimi se shërbimet mediatike nuk do të mbajnë programe me të cilat rrezikohet siguria nacionale, nxitet rrënimi i dhunshëm i rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, thiret në agresion ushtarak ose në konflikt të armatosur, nxitet ose përhapet diskriminimi, mosdurimi, ose urrejtja në bazë të racës, gjinisë, religjionit ose nacionalitetit. (Neni 48 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Sigurim se shërbimet mediatike nuk do të emetojnë programe që mund seriozisht ta dëmtojnë zhvillimin fizik, psikik ose moral të personave të mitur, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të panevojshme dhe respektim i masave teknike të përcaktuara nga Agjencia e brojtjes së të miturve (Neni 50 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele),
- Sigurim i drejtpërdrejtë dhe qasje të përhershme e shfrytëzuesve deri tek të dhënat për emrin, shenjën mbrojtëse, shenjën e identifikimit, adresën e selisë dhe të dhënat për realizimin e kontaktit me dhënësin e shërbimit, derisa ajo është e mundur edhe të dhëna për trupin rregullator të caktuar (Neni 51 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Rrespektimi i parimeve për emetimin e programeve (Neni 61 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i rregullave për përdorimin e gjuhës (Neni 64 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i rregullave për informimin e shkurtë të ngjarjeve për të cilat ekziston interesim i lartë tek publiku, ndërsa për të cilat të drejtat ekskluzive për emetim i kanë radiodifuzerët e tjerë (Neni 89 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i obligimeve për kohëzgjatjen minimale të emetimit ditor (Neni 90 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Radiodifuzerët mund të shfrytëzojnë shërbime telefonike me vlerë të shtuar, duke përfshirë edhe votimin telefonik në programet në të cilat ajo është e lejuar në pajtueshmëri me rregullat të caktuara nga Agjencia (Neni 93 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);
- Respektimi i ndalimit të transmetimit reklamim (Neni 99 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);

Veçanërisht ua bëjmë me dije të keni kujdes në dispozitat të cilat sillen për mbrojtjen dhe përkujdesjen e identitetit kulturor:

- Radiodifuzerët janë të obliguar që në ditë të emetojnë së paku 30% program burimor të krijuar në Republikën e Maqedonisë në gjuhën maqedonase ose në gjuhët e bashkësive joshumicë të cilat jetojnë në Republikën e Maqedonisë duke filluar nga viti 2014. Prej vitit 2015, obligimi prej 30% rritet



në 40%. Prej vitit 2016, obligimi prej 40% rritet në 50%. Radiodifuzerët janë të obliguar që së paku gjysmën e përqindjes nga obligimet të këtij neni, ta realizojnë në periudhën prej orës 7 deri në orën 19. (Neni 92 paragrafet 1, 3 dhe 12 од Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele);

- Sigurim më pakë 40% nga emetimi i muzikës vokale ose/ dhe vokale instrumentale në kohë prej 24 orëve të jetë në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e bashkësive etnike të cilat nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë (Neni 92 paragrafi 13 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele).

Me respekt,

Agjencia për shërbime mediatike audio dhe
audiovizuele
Kryetari,

Dr. Zoran Trajčevski